




# Raporti i Transparencës 2023

Grant Thornton LLC



# Content

Parathënie	3
Struktura ligjore, pronësia dhe qeverisja	4
Anëtarësimi me rrjetet globale	5
Monitorimi i jashtëm	12
Pavarësimi	13
Edukimi i vazhdueshëm profesional	14
Lista e subjekteve me interes publik të audituara gjatë vitit 2023	15
Shtojcat	16
Declaratë mbi efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të firmës	17
Deklarata e pavarësisë	18
Declaratë mbi politikën e perçjellur nga Firma lidhur me edukimin e vazhdueshëm të auditoreve	19
Bazat për shpërblimin e partnerëve të firmës	20
Informacion në lidhje me qarkullimin e përgjithshëm të firmës	21
Zyret tona	22



# Parathënie

Ky raport i transparencës është përgatitur në përputhje me kërkesat e nenit 10 të Ligjit Nr. 06 / L-032 për Kontabilitetin, raportimin financiar dhe auditimin e publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës nr. 3, i datës 19 prill 2018

Ky raport i transparencës është një deklaratë publike për klientet, komitetet e auditimit, rregullatorët dhe publikun e gjerë për angazhimin tonë për të ofruar shërbime cilësore të sigurisë për organizatat anëmbanë botës. Klientët tanë më të drejtë presin që ne të kemi politika dhe procedura të vendosura që nënkuptojnë cilësinë dhe nivelin e shërbimit që ata marrin nuk është vetëm një model, por i qëndrueshëm, pavarësisht se ku vepron.

Ky raport shpjegon se si funksionon firma, si sigurohemi që të kryejmë auditime të cilësisë më të lartë dhe të përshkruajmë ekspertizën, gjerësinë dhe thellësinë e firmës sonë dhe të Grant Thornton International.

Ky raport i transparencës përshkruan politikat dhe procedurat të cilat ishin në zbatim gjatë gjithë vitit 2023.

Në emër të Grant Thornton LLC



Marjan Andonov



Drejtor  
Prishtinë,  
30 prill 2024

# Struktura ligjore, pronësia dhe qeverisja

Grant Thornton LLC ("Firma") është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e inkuorporuar në Republikën e Kosovës më 4 gusht 2010. Data e përmbyshjes së Kompanisë është 20 dhjetor 2005. Adresa e regjistruar e selisë së saj është "Ruga Rexhep Mala", Nr.18 Prishtinë, Republika e Kosovës. .

Veprimtaria primare e regjistruar e firmës sipas Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës ("ARBK") është me Kodin 6920 - Kontabiliteti, mbajtja e librave dhe aktivitetet e auditimit dhe konsulenca tatimore. Firma është e regjistruar në Këshillin për Raportim Financiar të Kosovës - KKRF dhe i është dhënë leja e punës Nr. 06 e lëshuar më 1 mars 2010.

Deri më 31 dhjetor 2023, kompania ka të punësuar gjithsej 31 punonjës, nga të cilët 13 me periudhë të pacaktuar të punësimit dhe 15 me periudhë të caktuar punësimi. Kompania ka 2 auditorë ligjorë.

Kapitali i regjistruar i firmës është 2,500 euro. Në vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023, struktura e pronësisë është si vijon:

- Grant Thornton Consulting DOO – personi juridik i inkuorporuar në Republikën e Maqedonisë Veriore - posedon 49%  
Suzana Stavrikj – individ, banor i Republikës së Maqedonisë Veriore - zotëron 25.5%, auditor ligjor
- Marjan Andonov – individ, banor i Republikës së Maqedonisë Veriore - zotëron 25.5%, auditor ligjor

Struktura e qeverisjes së firmës përbëhet nga:

- Bordi i Drejtoreve- i cili përfaqëson Firmën në përputhje me Statutin dhe Ligjin për organizatat e biznesit, dhe përbëhet nga anëtarët e mëposhtëm:
  - Marjan Andonov - mbajtës i 25.5 % të të drejtave të votimit,
  - Suzana Stavrikj - mbajtës i 25.5 % të të drejtave të votimit, dhe
  - Slavcho Filipcevi - mbajtës i 49 % të të drejtave të votimit
- Agjentët e regjistruar / Drejtorët.

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023, personat e autorizuar të firmës për qëllime administrative janë:

- Ruzha Filipçeva – nënshkruese e autorizuar bankare
- Marjan Andonov – Drejtor Menaxhues dhe auditor ligjor, dhe
- Valon Damoni – Përfaqësues i Autorizuar.

# Anëtarësimi me rrjetet globale

Grant Thornton LLC është një firmë anëtare e Grant Thornton International Ltd ("Grant Thornton International").

## Grant Thornton LLC Kosovo

Grant Thornton LLC është firmë profesionale e shërbimit, duke shërbyer në një bazë të qëndrueshme dhe besnike të klientit që përfshin shumë institucione financiare, korporata dhe biznese familjare të vendit. Ekipi ynë ofron një gamë të plotë të shërbimeve profesionale duke përfshirë auditimin, taksat dhe konsulencat, duke kombinuar industrinë e thellë dhe ekspertizën e biznesit, burimet e gjera globale dhe teknologjitë, duke ndihmuar klientët për të përmirësuar performancën e tyre.

## Grant Thornton International

Grant Thornton është një nga organizatat lider në botë të firmave të pavarura të sigurimit, taksave dhe këshillimit. Këto firma ndihmojnë organizatat dinamike të zhbllokojnë potencialin e tyre për rritje duke ofruar këshilla kuptimplotë dhe të zbatueshme përmes një game të gjerë shërbimesh. Ekipet proaktive, të udhëhequra nga partnerë të arritshëm në këto firma, përdorin njohuri, përvojë dhe instinkt për të zgjidhur çështje komplekse për klientët në pronësi private, të listuar në publik dhe në sektorin publik. Mbi 73,000 njerëz të Grant Thornton, në mbi 147 tregje, janë të përqendruar për të bërë një ndryshim për klientët, kolegët dhe komunitetet në të cilat jetojmë dhe punojmë.

Të ardhurat totale globale për vitin e mbyllur më 30 shtator 2023 arrijnë në 7,5 miliardë dollarë.



# Kontrolli i menaxhimit të cilësisë

Grant Thornton LLC ka ndërtuar dhe zbatuar një sistem të brendshëm të kontrollit të cilësisë i cili bazohet në politikat dhe procedurat e vendosura nga Grant Thornton International, më tutje kërkesat e Standardit Ndërkombëtar për Kontrollin e Cilësisë nr. 1 të lëshuar nga IFAC dhe legjislacioni i Republikës së Kosovës. Sistemi i kontrollit të cilësisë i firmës synon të arrijë objektivat e mëposhtme:

- operacionet efikase të firmës,
- Raportimi i arsyeshëm financiar, dhe
- pajtueshmëria me standardet profesionale dhe legjislacioni.

Qasja e sistemit të menaxhimit të cilësisë bazohet në identifikimin e rreziqeve, gjë që i mundëson Firmës t'i përgjigjet ndryshimeve në mjedis. Një qasje e tillë synon të sigurojë përmirësim të vazhdueshëm dhe përbushje të kërkesave të ndryshme rregullatore.

## Procedurat e kontrollit të cilësisë të Grant Thornton International

Gjatë vitit 2023, sistemi i krijuar i menaxhimit të cilësisë ishte plotësisht në përputhje me standardet e mëposhtme të cilësisë profesionale, të publikuara nga organet e Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (IFAC):

- Standardi Ndërkombëtar për Menaxhimin e Cilësisë 1 (ISQM 1): Menaxhimi i cilësisë për firmat që kryejnë auditime ose rishikime të pasqyrave financiare, ose sigurime të tjera ose angazhime të shërbimeve të ndërlidhura
- Standardi Ndërkombëtar për Menaxhimin e Cilësisë 2 (ISQM 2): Rishikimet e Cilësisë së Angazhimit
- Standardi Ndërkombëtar i Auditimit 220 (i rishikuar): Kontrolli i Cilësisë për Auditimet e Informacionit Historik Financiar
- Kodi i Etikës i IESBA për Kontabilistët Profesionistë

Firma monitoron sistemin e saj të kontrollit të cilësisë në mënyrë të vazhdueshme, i cili gjithashtu përfshin kontrollin e brendshëm të angazhimeve të përzgjedhura të përfunduara. Firma vlerëson sistemin e menaxhimit të cilësisë në baza vjetore.

## Sistemi i menaxhimit të cilësisë

Sistemi i monitorimit të cilësisë së Firmës përfshin: Politikat dhe procedurat e dokumentuara për cilësinë e operacioneve (Manuali i Menaxhimit të Cilësisë), rolet dhe përgjegjësitë e përcaktuara rreptësisht për zbatimin e politikave dhe procedurave, si dhe mbikëqyrjen e krijimit dhe efektivitetit operacional të sistemit të vendosur të menaxhimit të cilësisë, përmes proceseve të mëposhtme:

- identifikimin e rreziqeve për arritjen e objektivave të cilësisë;
- hartimin dhe zbatimin e përgjigjeve ndaj rreziqeve të vlerësuara të cilësisë;
- monitorimin e hartimit dhe efikasitetit operacional të politikave dhe procedurave duke monitoruar aktivitetet e integruara në procese; dhe
- Përmirësimi i vazhdueshëm i sistemit të menaxhimit të cilësisë në rastet kur identifikohen fusha për përmirësim, duke kryer analiza rrënjësore dhe duke zbatuar veprime korigjuese.

Objektivat e postës së sistemit të menaxhimit të cilësisë janë:

- Të ofrojë një qasje të bazuar në rrezik për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë;
- Të sigurojë pajtueshmëri me ligjet dhe kërkesat rregullatore;
- Të hartojë, zbatojë dhe sigurojë funksionimin e një sistemi të menaxhimit të cilësisë që ofron siguri të arsyeshme se:
  - Firma dhe punonjësit e saj përmbushin përgjegjësitë e tyre në përputhje me standardet profesionale dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore, si dhe të kryejnë angazhimet në përputhje me standardet dhe kërkesat; dhe
  - Raportet e auditimit korrespondojnë me rrethanat.
- Të hartojë dhe zbatojë procedurat e duhura të kontrollit të brendshëm të cilësisë, identifikimin e shkaqeve të mangësive dhe planin e veprimeve për tejkalimin e mangësive; dhe
- Të sigurojë që Firma është fleksibile dhe e aftë për t'iu përgjigjur ndryshimeve në mjedis (rregullatore, teknike, mjedisore, etj.).

Sistemi i menaxhimit të cilësisë përbëhet nga komponentët e mëposhtëm:

## Qeverisja dhe Udhëheqja

Firma ka krijuar një strukturë drejtuese e cila:

- zotëron aftësi, autoritet dhe integritet të mjaftueshëm të nevojshëm për të kryer në mënyrë efektive rolin e tyre;
- promovon një kulturë të brendshme që njeh cilësinë si thelbësore në kryerjen e të gjitha angazhimeve;
- percepton mjedisin dhe jep mendime të ndryshme për të ofruar shërbime me cilësi të lartë;
- demonstroi përkushtim për përmirësimin e sistemeve të brendshme dhe përdorimin e tyre për të mbështetur ofrimin e shërbimeve me cilësi të lartë;
- punon me firma të tjera anëtare të Grant Thornton në mënyrë të hapur, bashkëpunuese dhe konstruktive.

Bordi drejtues dhe menaxherët janë përgjegjës dhe monitorojnë funksionimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë, zhvillimin e politikave dhe procedurave të reja, si dhe sanksionimin e duhur në rast të mospërputhjes me politikat dhe procedurat e përcaktuara. Bordi Drejtues dhe menaxherët, në nivel vjetor, bënë një vlerësim dhe vlerësuan se sistemi i menaxhimit të cilësisë ofron siguri të arsyeshme se objektivat e sistemit të menaxhimit të kontrollit janë përmbushur.

Sipas sistemit të vendosur të menaxhimit të cilësisë, të gjithë punonjësit e Firmës janë të detyruar që pas punësimit dhe më pas në baza vjetore, të nënshkruajnë një deklaratë se kanë lexuar, kuptuar dhe zbatuar politikat dhe procedurat sipas sistemit të menaxhimit të cilësisë.

## Kërkesat etike

Firma ka vendosur kërkesat përkatëse etike në mënyrë që:

- angazhimet të kryhen në mënyrë etike, të qartë dhe të ndershme;
- për të shmangur shërbimet që përfshijnë ose nxisin sjellje joetike; punonjësit të kryejnë detyrat e tyre në mënyrë objektive;
- bashkëpunimi me rregullatorët;
- respektimin dhe mbrojtjen e konfidencialitetit të informacionit të marrë nëpërmjet marrëdhënieve profesionale dhe të biznesit.

Të gjithë punonjësit e Firmës janë përgjegjës ndaj klientëve dhe firmës që njohin dhe zbatojnë rregullat dhe parimet etike në punën e tyre dhe kryerjen e angazhimeve të auditimit në përputhje me kërkesat e Kodit të Etikës për Kontabilistët Profesionalistë të publikuar nga Bordi i Kontabilistëve të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës.



Firma ka vendosur dhe zbaton masat e duhura në lidhje me respektimin dhe zbatimin e kërkesave etike. Këto përfshijnë kufizime në:

- Interesi financiar ndërmjet klientëve të auditimit;
- Hua dhe garanci;
- Marrëdhënie të ngushta biznesi;
- Punësimi;
- Ofrimi i shërbimeve për klientët e auditimit;
- Anëtarësimi në organet drejtuese të klientëve të auditimit;
- Lidhja afatgjatë e niveleve më të larta të auditimit ndërmjet klientëve të auditimit;
- Ofrimi i shërbimeve jo audituese për klientët e auditimit;
- Metoda e përcaktimit të tarifave për shërbimet e auditimit dhe politika e çmimeve;
- Kufizimet në marrjen e dhuratave;
- Procedurat në lidhje me paditë aktuale ose të mundshme.

## Pranimi dhe vazhdimësia e angazhimit

Firma ka krijuar dhe zbatuar politika dhe procedura të përshtatshme për pranimin, zgjatjen ose tërheqjen e angazhimeve. Politikat dhe procedurat e vendosura synojnë të ofrojnë siguri të arsyeshme që Firma pranon dhe vazhdon me angazhimet e auditimit bazuar në sigurinë e marrë më parë në lidhje me:

- Integritetin e klientit;
- Kompetencën e anëtarëve të ekipit të angazhuar, kapacitetet në dispozicion, koha dhe burimet;
- Pajtueshmërinë me kërkesat etike.

Procedurat e aplikuara janë të dokumentuara në forma të standardizuara për pranimin/zgjerimin e angazhimeve të auditimit. Këto formularë janë të detyrueshëm për të gjitha angazhimet e auditimit. Procedurat për pranimin, zgjatjen ose tërheqjen e angazhimeve përfshijnë:

- Mbledhjen dhe analizën e të dhënave për klientët potencial, pra përditësimi i të dhënave për klientët ekzistues dhe integriteti i tyre;
- Identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve të pranimit/vazhimit të angazhimit të auditimit;
- Vlerësimin e kompetencës së anëtarëve të ekipit të angazhuar, kapaciteteve në dispozicion, kohës dhe burimeve;
- Ekzaminimin e rreziqeve të mundshme të konfliktit të interesave dhe marrja e masave të duhura për eliminimin/minimizimin e tyre;
- Procedurat e verifikimit të kyçjes;
- Shqyrtimin e nevojës për punësimin e ekspertëve në fusha të caktuara gjatë ekzekutimit të angazhimit;
- Përcaktimin e nevojës për të përfshirë një kontrollues të cilësisë në angazhimin e auditimit.

GTIL ka vendosur kritere për angazhimet kyçe të auditimit (Key Assurance Engagements - AKA) që firmat anëtare duhet t'i aplikojnë gjatë vlerësimit të angazhimeve të mundshme. Firmat anëtare i raportojnë Komitetit të Rishikimit Global për angazhimet e mundshme që plotësojnë këto kritere të AKA-së. Komiteti i Pranimit të Angazhimit të Auditimit shqyrton aplikacionet e dorëzuara të AAK-së në mënyrë që të vlerësojë aftësinë e firmës anëtare për të ofruar një auditim të cilësisë së lartë.

## Burimet njerëzore

Firma ka krijuar dhe zbatuar politika dhe procedura të përshtatshme në lidhje me burimet njerëzore, të cilat garantojnë:

- Punësimin e personave me aftësi dhe kompetencë të përshtatshme profesionale për kryerjen e detyrave të punës;
- Ruajtjen e kompetencës profesionale të punonjësve nëpërmjet edukimit të vazhdueshëm profesional dhe vlerësimit të njohurive të punonjësve.

Këto procedura përfshijnë:

- Planifikimin e nevojave për punësim dhe vendosja e kritereve të përshtatshme për burimet e punësimit, metodat e tërheqjes së stafit, vlerësimin e punonjësve potencialë;
- Emërimin e personave përgjegjës për punësim;
- Verifikimin i efektivitetit të punësimit, duke përfshirë verifikimin e pajtueshmërisë me procedurat e përcaktuara;
- Përcaktimin e kualifikimeve, përvojës dhe ekspertizës së nevojshme të stafit potencial në nivele të ndryshme profesionale, pra përcaktimi i përshkrimeve të punës dhe përgjegjësi për çdo nivel profesional.

## Performanca e angazhimit

- Firma ka vendosur dhe zbaton procedurat e duhura që sigurojnë konsistencë në cilësinë e kryerjes së angazhimeve. Procedurat kryesore përfshijnë:
- Njohja e anëtarëve të ekipit me natyrën, kompleksitetin dhe kohëzgjatjen e angazhimit, detyrat, përgjegjësitë dhe komunikimin e tyre;
- Procesi i përputhshmërisë me standardet e zbatueshme të angazhimit;
- Proceset e mbikëqyrjes mbi kryerjen e angazhimit dhe menaxhimit të ekipit të angazhimit;
- Metodatat e kontrollit të ekzekutimit të detyrave të punës, vlerësimet e rëndësishme të bëra dhe raportimi në formë raporti nga auditimi i kryer;
- Vlerësimi i përshtatshmërisë dhe mjaftueshmërisë së dokumentacionit nga angazhimi, si dhe përcaktimi i kornizës kohore dhe shtrirjes së kontrollit të angazhimit;
- Proceset e përditësimit të metodologjive, politikave dhe procedurave për kryerjen e angazhimeve të auditimit.

## Monitorimi

Firma ka krijuar dhe zbatuar politika të përshtatshme për kontrollin e cilësisë së angazhimeve në mënyrë që:

- ofrimin e një sigurie të arsyeshme që politikatat dhe procedurat e menaxhimit të cilësisë janë relevante, të përshtatshme dhe funksionale
- në mënyrë efektive;
- kryerjen e një kontrolli të brendshëm të cilësisë së angazhimeve të përfunduara në baza periodike; dhe
- identifikimin e faktorëve të përbashkët për dobësitë e identifikuar dhe marrjen e veprimeve të duhura për tejkalimin e tyre.

Rishikimi i cilësisë së performancës së angazhimeve është një proces veçanërisht i rëndësishëm në sistemin e menaxhimit të cilësisë. Firma ka vendosur dhe zbatuar procedurat e duhura të rishikimit të cilësisë në nivel angazhimi që ofrojnë një vlerësim objektiv të vlerësimeve të rëndësishme të bëra nga ekipi i auditimit gjatë ekzekutimit të angazhimit, si dhe konkluzioneve të arritura gjatë formulimit të raportit të auditimit. Firma aplikon metodologjinë dhe kriteret e duhura, të zhvilluara nga G-TIL, në kategorizimin/profilimin e angazhimeve në aspektin e rrezikut të grupit të auditimit dhe rrezikut të angazhimit. Bazuar në vlerësimin e korrelacionit midis këtyre dy rreziqeve të lidhura në një model të përshtatshëm, Firma përcakton se për cilat angazhime do të caktohet një person që do të kryejë një rishikim të pavarur të cilësisë të një angazhimi të kryer (recensues i cilësisë). Një rishikim i pavarur i cilësisë është i detyrueshëm për angazhimet e auditimit të klientëve të listuar, si dhe për kompanitë me interes publik.

Firma ka vendosur dhe zbaton kritere të veçanta për përzgjedhjen dhe emërimin e inspektorit të cilësisë, të cilat bazohen në kompetencën profesionale, përvojën dhe ekspertizën, zotërimin e licencave profesionale, pavarësinë dhe objektivitetin e inspektorit. Procedurat e kryera nga kontrolluesi i cilësisë së angazhimit përfshijnë:

- Diskutim me partnerin e angazhimit;
- Rishikimi i pasqyrave financiare - subjekt i auditimit dhe raporti i auditimit;
- Kontrollimi i dokumenteve të përzgjedhura të punës, veçanërisht lidhur me vlerësimet dhe konkluzionet e rëndësishme të auditimit;
- Shtrirja e kontrollit të cilësisë së angazhimit varet nga kompleksiteti i angazhimit dhe rreziku i papërshtatshmërisë së raportit të auditimit në rrethana të caktuara.

## Lista e klientëve të kufizuar

Firma ka krijuar dhe përditëson rregullisht listën e klientëve kufizues. Punonjësve u kërkohet të kontrollojnë këtë listë përpara se të marrin ndonjë vendim investimi sipas tyre dhe përpara se të nënshkruajnë deklaratën vjetore të pavarësisë.

## Deklarata e Pavarësisë

Para fillimit të aktiviteteve të planifikuara në angazhimet e auditimit, çdo anëtar individual i ekipit nënshkruan një deklaratë të pavarësisë dhe ia dorëzon atë partnerit të angazhimit. Partneri i angazhimit kontrollon dhe verifikon që nuk ka konflikt interesi dhe pengesa përse i përket pavarësisë së anëtarëve të ekipit të angazhimit.

## Rishikuesit e cilësisë së rotacionit të partnerëve dhe angazhimit

Firma ka vendosur kriteret dhe procedurat e duhura të rotacionit të detyrueshëm të partnerit të angazhimit dhe personave përgjegjës për kontrollin e kontrollit të cilësisë së angazhimeve me klientët me interes publik pas skadimit të një periudhe maksimumi shtatë vjeçare. Këta persona nuk mund të ripunësohen në ekipin e auditimit para skadimit të dy viteve të tjera pas periudhës së angazhimit të tyre.

## Konfidencialiteti dhe mbrojtja e të dhënave

Firma ka vendosur dhe zbaton masat e duhura në lidhje me konfidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave si një nga kërkesat themelore profesionale. Aktivitetet e biznesit, të dhënat dhe informacionet financiare të klientëve trajtohen si konfidenciale të biznesit.

Kërkesat e Firmës nga punonjësit e saj përfshijnë kufizime në lidhje me zbulimin e të dhënave të klientit dhe të dhëna të tjera që lidhen me aktivitetet e biznesit, të dhënat financiare dhe informacionin në komunikimin me palët e treta, personat me klientët, si dhe ndërmjet punonjësve të Firmës që nuk janë të përfshirë në angazhimin e auditimit. Masat për mbrojtjen e të dhënave përfshijnë masat për sigurimin e dokumenteve të shkruara dhe elektronike, të dhënave dhe informacioneve gjatë kryerjes së angazhimeve në ambientet e klientit, sigurinë e kompjuterëve personalë, automjeteve zyrtare, si dhe masat e duhura mbrojtëse të aplikuara në komunikimin elektronik me klientët dhe ndërmjet punonjësve.

## Zhvillimi i vazhdueshëm profesional

Aftësitë teknike dhe përvoja e stafit tonë përfaqësojnë burimin më të madh që ne ofrojmë për klientët tanë. Për të siguruar zhvillimin e plotë të këtyre aftësive dhe garancitë më të mira për demonstrimin e këtyre përvojave, Firma kërkon që punonjësit e saj të zotërojnë nivelin e duhur të licencave profesionale në fushën e tyre. Politika e përgjithshme e Firmës në fushën e arsimit është të ofrojë trajnime për personelin e saj, në lidhje me aktivitetet e tyre dhe nivelet e njohurive dhe ekspertizës. Nevojat për trajnim përcaktohen nga Menaxhmenti i Firmës, në përputhje me nevojat për trajnim të punonjësve.

Plani i trajnimit përcaktohet në baza vjetore dhe çdo punonjës duhet të marrë 40 orë trajnim në vit.

Ka programe të veçanta arsimore për çdo kategori punonjësish. Punonjësit informohen me kohë për seminarët kyçe që u kërkohet të marrin pjesë. Seminarët menaxhohen dhe zhvillohen nga partnerë dhe menaxherë auditimi që janë punonjës të Firmës ose profesionistë të jashtëm për çështje të veçanta, si dhe ndiqen trajnime online të hartuara nga GTIL. Seminarët mbulojnë një sërë temash për zhvillimin e njohurive dhe teknikave të auditimit, të fokusuara në auditimin, sigurimin, SNRF-të, legjislacionin përkatës dhe të ngjashme.

Pavarësisht se shumica e trajnimeve teknike kryhen brenda vetë firmave anëtare, GTIL organizon gjithashtu trajnime dhe programe të vazhdueshme të destinuara për stafin e auditimit për të gjitha firmat anëtare në lidhje me metodologjinë dhe standardet për auditimin, teknologjinë e duhur dhe SNRF. .

## Emërimi i personit përgjegjës për angazhimin, anëtarëve të grupit të auditimit dhe ekspertëve dhe specialistëve

Firma ka vendosur dhe zbatuar procedurat e duhura që përfshijnë planifikimin e detajuar të personelit të kërkuar për ekzekutimin e çdo angazhimi individual të auditimit, si dhe planifikimin e detajuar të personelit të kërkuar në nivel të sezonit të auditimit. Planifikimi i personelit të nevojshëm për realizimin e angazhimeve individuale përfshin:

- Verifikimin paraprak të aftësisë dhe kompetencës profesionale të burimeve në dispozicion për sa i përket njohurive dhe përvojës praktike në kryerjen e angazhimeve të natyrës, kompleksitetit, industrisë së ngjashme, etj.;
- Përcaktimin e strukturës së ekipit të auditimit për sa i përket ekspertizës, kualifikimeve dhe përvojës së nevojshme të partnerit përgjegjës dhe anëtarëve të grupit të auditimit;
- Vlerësimin dhe përcaktimin e nevojës për përfshirjen e ekspertëve dhe specialistëve në ekipin e auditimit;
- Përgatitjen e një buxheti të detajuar kohor të angazhimit

## Rishikimi i brendshëm i cilësisë

Firma ka projektuar, dokumentuar dhe zbatuar një sistem të brendshëm të kontrollit të cilësisë. Qëllimi i këtij sistemi është të ofrojë siguri të arsyeshme se standardet, politikat dhe procedurat profesionale të Firmës janë vendosur dhe zbatuar plotësisht dhe në mënyrë adekuatë. Firma kryen inspektimin dhe vlerësimin e sistemit të kontrollit të cilësisë në mënyrë të vazhdueshme, duke përfshirë inspektimin periodik të angazhimeve të përzgjedhura të auditimit. Ky proces, i cili mbulon proceset më të gjera të Firmës si dhe verifikimin e angazhimeve të përzgjedhura të auditimit, quhet Sistemi i Rishikimit të Brendshëm të Cilësisë.

Procedurat për kontrollimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të cilësisë përfshijnë:

- Kontrollimi i efektivitetit operacional të procedurave për pranimin dhe zgjerimin e angazhimeve;
- Çështjet etike dhe pavarësia;
- Deklaratat vjetore të pavarësisë;
- Kapacitetet dhe kompetenca profesionale;
- Edukimi i punonjësve dhe emërimi i personave dhe niveleve të angazhimit;
- Delegimi i detyrave dhe përgjegjësi;
- Konsultimet, zgjidhjen e ankesave dhe ankesave.

# Monitorimi i jashtëm

Grant Thornton LLC ishte subjekt i kontrollit të jashtëm të cilësisë - Grant Thornton International të performuar nga Grant Thornton Audit Review (GTAR) në shtator 2020. Kontrolli i cilësisë mbuloi të gjithë sistemin e kontrollit të cilësisë së Firmës, si dhe angazhimet e zgjedhura në auditimet ligjore të pasqyrave financiare për viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019.

Firma mori një opinion të pakualifikuar duke deklaruar se sistemi i kontrollit të cilësisë së auditimit të Firmës është projektuar dhe zbatuar në mënyrë të përshtatshme për të ofruar siguri të arsyeshme të konformitetit me standardet profesionale të aplikueshme dhe kërkesat e GTIL në të gjitha aspektet materiale.

Gjatë shkurtit 2022, përfaqësuesit e SHKÇAK kanë shqyrtuar aktivitetet vjetore të raportuara për vitin kontabël të përfunduar më 31 dhjetor 2020 të auditorëve të regjistruar ligjor të Firmës – Suzana Stavrikj dhe Marjan Andonov.

Objekt i rishikimit ishte vlerësimi i përputhshmërisë së procedurave të auditimit të kryera me kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit – ISA.

Në bazë të rishikimit ata kanë nxjerrë raporte vlerësimi ku kanë konstatuar se të gjitha procedurat e auditimit të kryera nga të dy auditorët ligjor janë kryer në përputhje me SNA-të.

# Pavarësia

Firma ka hartuar, zbatuar dhe monitoruar zbatimin e politikave dhe procedurave përkatëse për të garantuar pavarësinë, integritetin dhe objektivitetin në kryerjen e auditimit dhe angazhimeve të tjera të sigurimit gjatë vitit 2023.

Si një firmë anëtare e Grant Thornton International, Firmës i kërkohet të miratojë politika dhe procedura që janë krijuar për të mbrojtur pavarësinë në angazhimet e sigurimit dhe për të identifikuar rrethanat që mund të përbëjnë një konflikt interesi. Politikat dhe procedurat e pavarësisë globale bazohen në Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionistë të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës me shtesa për të rregulluar pajtueshmërinë me pavarësinë tonë globale dhe proceset e kontrollit të marrëdhënieve ndërkombëtare. Firmës i kërkohet t'u përmbahet kërkesave rregullatore vendore aty ku janë më kufizuese.

## Sistemi global i pavarësisë (GIS)

Shmangia e interesave financiare në një klient të sigurimit, ose filialin e tij, të ndaluar nga rregullat e pavarësisë është një objektiv kyç në ruajtjen e pavarësisë së firmave anëtare dhe ekipeve të angazhimit të shërbimit ndaj klientit. Grant Thornton përdor GIS - një sistem i automatizuar gjurmimi që identifikon entitetet e kufizuara (emetuesit e letrave me vlerë të tregtuara publikisht në të cilat interesat financiare janë të ndaluara ose të kufizuara). Ky informacion vihet në dispozicion për të gjithë personelin në të gjitha firmat anëtare.

Firmat anëtare, partnerët, menaxherët që përballen me klientët, bashkëshortët, ekuivalentët e bashkëshortëve dhe vartësit u kërkohet të mbajnë një regjistër të interesave të tyre financiare në GIS. GIS monitoron përputhshmërinë me politikat e interesit financiar duke krahasuar interesat financiare të regjistruara në sistem me një listë të azhurnuar rregullisht të subjekteve të kufizuara. Individët dhe zyrtari i tyre i pajtueshmërisë njoftohen nga sistemi në rast se një interes financiar i regjistruar është në një njësi ekonomike të kufizuar. GIS ofron një mekanizëm për të ndihmuar individin në përcaktimin, bazuar në faktet dhe rrethanat, nëse është e përshtatshme për të mbajtur interesin financiar. Kur nuk është e përshtatshme për të mbajtur interesin financiar, ai duhet të asgjësohet.

Monitorimi i pajtueshmërisë me GIS kryhet si në nivel të firmës anëtare ashtu edhe në nivel global.

## Kontrollimi i marrëdhënieve

Politika e Grant Thornton kërkon që firmat anëtare dhe personeli profesional nga të gjitha linjat e shërbimit të ruajnë objektivitetin e tyre kur ofrojnë shërbime për klientët. Për të shmangur konfliktet e interesit dhe kërcënimet ndaj pavarësisë që rrjedhin nga ofrimi i shërbimeve jo audituese për klientët e auditimit ose filialet e tyre, identifikimi i çdo marrëdhënieje ekzistuese me klientin përpara se të pranohet një detyrë është thelbësor.

Politikat dhe procedurat në firmat anëtare dhe në nivel global përfshijnë procese të dizajnuara për të identifikuar marrëdhëniet ekzistuese. Këto procese përfshijnë gjithashtu kërkesat për konsultim të duhur kur identifikohen marrëdhëniet, përpara pranimit të detyrave të reja.

## Procedurat e pranimit të klientit

Arritja e përsosmërisë profesionale nënkupton pranimin dhe mbajtjen e klientëve që ndajnë objektivat e Grant Thornton për cilësinë dhe integritetin. Procedurat globale të pranimit/vazhdimin të klientëve të Grant Thornton integrohen me politikat e firmave anëtare. Proceset e pranimit/vazhdimin u ofrojnë firmave anëtare informacion për të gjykuar nëse njësi a plotëson ose i tejkalon standardet e nevojshme të integritetit dhe nëse firma anëtare ka kapacitetin për të kryer një auditim me cilësi të lartë.

Grant Thornton vendos kriteret kryesore të caktimit të sigurimit (KAA) që firmat anëtare përdorin për të vlerësuar detyrat e mundshme. Firmat anëtare i dorëzojnë detyrat e mundshme që plotësojnë kriteret e AAK-së në një komitet ndërkombëtar për shqyrtim për shqyrtim.

Shqyrtimet e komisionit të rishikimit të pranimit të klientit të sigurimit kanë dorëzuar AKA për të gjykuar nëse firma anëtare ka aftësinë për të kryer auditimin me një nivel të lartë të cilësisë. Ky komitet kryesohet nga drejtori ekzekutiv - kontrolli i cilësisë dhe përbëhet nga partnerë të menaxhimit të rrezikut/kontrollit të cilësisë nga një grup i ndryshëm firmash anëtare të përzgjedhura.

# Edukimi i vazhdueshëm profesional

Grant Thornton LLC deklaron se gjatë vitit 2023 ka inkorporuar të gjitha politikat e auditimit të dizajnuara për të siguruar që auditorët kanë vazhduar të ruajnë kompetencën e tyre përmes përmirësimit të vazhdueshëm të njohurive teorike, aftësive profesionale dhe vlerave të tyre në përputhje me standardet profesionale dhe rregulloret ligjore përmes trajnimeve të vazhdueshme të organizuara nga Firma. dhe institucionet tjera relevante në vend.

Gjatë vitit 2023, stafi i Firmës ka marrë pjesë në disa trajnime teknike me minimum 40 orë për punonjës.

Programet përfshijnë sistemin e kontrollit të brendshëm të cilësisë, temat e ISA si auditimet në grup, të ardhurat nga auditimi, procedurat analitike si dhe udhëzimet teknike dhe interpretuese të SNRF-ve etj.

Udhëzime plotësuese ofrohen nëpërmjet buletineve mbi çështjet aktuale të auditimit dhe kontabilitetit dhe trajnimet online të GTIL.

# Lista e subjekteve me interes publik të audituara gjatë vitit 2023

Lista e subjekteve me interes publik të audituara gjatë vitit 2023 është si në vijim:

Nr	Emri i klientit të auditimit	Industria
1.	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës	Bankë
2.	Banka për Biznes Sh.a.	Bankë
3.	NLB Bank Sh.a	Bankë
4.	Banka Credins Kosova Sh.a	Bankë
5.	Türkiye İş Bankası A.Ş. – Dega në Kosovë	Bankë
6.	Moneta Sh.p.k.	Mikrofinancë
7.	KS Siguria sh.a.	Sigurime
8.	Byroja Kosovare e Sigurimeve	Sigurime
9.	Neptun Kosova Shpk	Tregtare
10.	Birra Peja sh.a.	Prodhim
11.	Coca Cola Hellenic Bottling Firm Kosovo LLC	Tregtare

<sup>1</sup> Sipas Ligjit Nr. 06 / L -032 Për Kontabilitetin, raportimin financiar dhe auditimin, entitetet me interes publik (PIE) - janë:

institucionet financiare subjekt i licencimit nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) sipas legjislationit në fuqi; ndërmarrjet publike dhe shoqërore dhe organizatat e biznesit që plotësojnë kriteret për t'u klasifikuar si organizatë e madhe e biznesit, në përputhje me këtë ligj; subjektet letrat me vlerë të cilave pranohen për tregti në një treg të rregulluar në Republikën e Kosovës, në përputhje me legjislationin në fuqi; subjektet letrat me vlerë të cilave pranohen për tregti në një treg të rregulluar në Republikën e Kosovës, në përputhje me legjislationin në fuqi



# Shtojcat



# Declaratë mbi efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të firmës

Gjate vitit 2023, Grant Thornton LLC ka zbatuar politikat dhe procedurat per funksionimin efektiv te sistemit te brendshem te kontrollit te cilesise.

Prishtinë,  
30 prill 2024

Certifikuar nga



Marjan Andonov  
Drejtor



# Deklarata e pavarësisë

Grant Thornton LLC ka ndërtuar dhe zbatuar politika dhe procedura te brendshme lidhur me shqyrtimin e brendshëm të pajtueshmerisë dhe pavarësisë. Këto politika dhe procedura janë realizuar plotësisht gjatë vitit 2023.

Prishtinë,  
30 prill 2024

Certifikuar nga:



Marjan Andonov  
Drejtör



# Deklaratë mbi politikën e percjellur nga Firma lidhur me edukimin e vazhdueshëm të auditoreve

Gjatë vitit 2023, Grant Thornton LLC ka ekzekutuar politikën për arsimim të vazhdueshëm profesional të auditoreve të licencuar dhe stafit të saj të auditimit.

Prishtinë,  
30 prill 2024

Certifikuar nga:



Marjan Andonov  
Drejtor



# Bazat për shpërblimin e partnerëve të firmës

Firma zbaton kriteret e mëposhtme në përcaktimin e shpërblimit të partnerëve të auditimit:

## Përgjegjësia

Shpërblimi përcaktohet në bazë të nivelit të përgjegjësive të alokuara për partnerin, si dhe pozitën në hierarkinë profesionale të Firmës.

## Rezultatet e arritura

Shpërblimi përcaktohet në bazë të rezultateve të arritura, cilësinë e performancës dhe afatet e përmbushura gjatë kryerjes së angazhimeve.

# Informacion në lidhje me qarkullimin e përgjithshëm të firmës

Tabela më poshtë paraqet ndarjen e të hyrave të realizuara të Kompanisë për vitet e mbyllura më 31 dhjetor 2023:

Kategoria	(në euro)
1. Shërbimet e auditimit	190,557.00
2. Shërbimet e sigurisë	3,500.00
3. Kontabilitet, taksa dhe shërbime të konsulencës	498,138.00
4. Shërbime tjera	30,967.00
<b>Gjithsej të ardhurat e realizuara</b>	<b>723,162.00</b>

# Zyret tona

Grant Thornton LLC

“Rexhep Mala”, Nr.18  
10 000 Pristina  
Republic of Kosovo

T +381 38 247 771  
T +381 38 247 801  
F +381 38 247 802  
[www.grantthornton-ks.com](http://www.grantthornton-ks.com)



---

[grantthornton-ks.com](https://www.grantthornton-ks.com)

© 2023 Grant Thornton LLC. All rights reserved.

Grant Thornton' i referohet markës nën të cilën firmat anëtare të Grant Thornton ofrojnë shërbime të sigurisë, shërbime tatimore dhe këshilluese për klientët e tyre dhe / ose i referohet një ose më shumë firmave anëtare, siç e kërkon konteksti. Grant Thornton International Ltd (GTIL) dhe firmat anëtare nuk janë një partneritet në të gjithë botën. GTIL dhe secila firmë anëtare është një entitet i veçantë juridik. Shërbimet ofrohen nga firmat anëtare. GTIL nuk ofron shërbime për klientët. GTIL dhe firmat e saj anëtare nuk janë agjentë të, dhe nuk e detyrojnë, njëri-tjetrit dhe nuk janë përgjegjës për veprimet ose mosveprimet e njëri-tjetrit.